



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS

16-07-2018

13-60



DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbështetje të nenit 68 paragrafi 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28, nenit 12 dhe 22 të Rregullorës së MF, nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve

Drejtoria për Shëndetsi dhe Mirëqeni Sociale në komunën e Malishevës në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit të komunës, bëjnë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Ftohen organizatat joqeveritare të sferës së shërbimeve sociale dhe familjare, që janë aktive dhe zhvillojnë aktivitetet e tyre në komunën e Malishevës, se mund të aplikojnë me projektet e tyre për përkrahje financiare nga Komuna e Malishevës për vitin 2018.

Dokumentet e kërkuara për aplikim:

1. Projektpropozimi
2. Aplikacioni
3. Dokumenti identifikues
4. Licencë për personat juridik
5. Certifikata e regjistrimit (për persona juridik)
6. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (për persona fizik)
7. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik)
8. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit

Subvencionet për shërbime sociale dhe familjare

Komuna e Malishevës do të ndajë subvencione për shërbimeve shëndetsore shtëpiake,

Duhet të kete license qe ofron keto sherbime.

1. Përkujdesi shtëpiak, vizita shtëpiake
2. Trasporti i pacientëve me regjim –dialize
3. Trasorti i pacientëve me aftësi të kufizuar
4. Paisje për personat me aftësi të kufizuar

Mbështetja financiare do të ofrohet varësisht nga vlerësimi i projektiti nga Komisioni dhe mundësitë buxhetore të Komunës.

Tërheqja dhe dorëzimi i aplikacioneve mund të bëhet në ndërtesën e Komunës, kati I, në Qendrën për Shërbime për Qytetarët.

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në zarf të mbyllur, ku brenda zarfit vendoset një kopje e printuar e të gjithë dokumentacionit origjinal të kërkuar.

Aplikuesit mund ta dorëzojnë dokumentacionin brenda afatit prej 15 ditë pune nga dita e shpalljes në uebfaqen e Komunës.



Kryetari i Komunës

Ragip Begaj